



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1474 prot.  
110

Tiranë më 06.12.2018

REKOMANDIM

Nr. 27, datë 06.12.2018

PËR KONTROLLUESIN ELITE CONSULTING SH.P.K

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Elite Consulting" Sh.p.k.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 256, datë 19.10.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Elite Consulting" Sh.p.k, me objekt kontrolli:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi A. A, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

Kontrolluesi IuteCredit Albania Sh.a ka autorizuar shoqërinë Elite Consulting Sh.p.k, për mbledhjen e detyrimeve të pa-arkëtuara të IuteCredit Albania Sha, sipas marrëdhënies kontraktuale të lidhur ndërmjet tyre, të mbledhë detyrimin bazuar në marrëveshjen e kredisë me ankuesin z. \_\_\_\_\_, pasi huamarrësi është vonuar në kryerjen e pagesës së huas sipas kësaj marrëveshje.

IuteCredit Albania Sh.a ka vendosur në dispozicion të Elite Consulting Sh.p.k të dhënat personale si emrin, atësinë dhe mbiemrin e debitorit, garantuesit/dorëzanësit, adresën e vendit të banimit, vendit të punës së debitorit, garantuesit, dorëzanësit, qytetin, shumën e

detyrimet ku janë përfshirë, interesat, penalitetet dhe çdo shpenzim tjetër që ka bërë banka për këtë debitor.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se Elite Consulting Sh.p.k ka përpunuar/përhapur të dhënat e ankuesit duke dërguar në adresat e punës së prindërve të tij dy njoftime për shlyerjen e detyrimit të kredisë së z. . Në kontratën e lidhur ndërmjet ankuesit dhe kontrolluesit IuteCredit Albania Sh.a nuk ishte e parashikuar që kërkesa për kryerjen e pagesës së huas mund t'u bëhej me dije edhe subjekteve të tjera të të dhënave (prindërve të ankuesit të cilët nuk janë në rolin e garantuesit/dorëzanësit).

Në marrëdhënien kontraktuale të lidhur me Elite Consulting Sh.p.k me qëllim mbledhjen e detyrimeve të pa-arkëtuara të IuteCredit Albania Sh.a, është parashikuar që Elite Consulting Sh.p.k të përpunojë të dhënat bazuar në marrëveshjen e kredisë me ankuesin. Konstatohet se Elite Consulting Sh.p.k nuk është në gjendje që të provojë marrjen e pëlqimit për përpunimin/përhapjen e të dhënave drejt subjekteve të tjera të të dhënave të cilët nuk janë objekt i marrëveshjes së kredisë të nënshkruar nga ankuesi me shoqërinë IuteCredit Albania Sh.a.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se në marrëveshjen midis IuteCredit Albania Sh.a dhe Elite Consulting Sh.p.k nuk janë parashikuar detyrimet në raport me nenin 20 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi", i ndryshuar, konstatohet se:

- Nuk janë parashikuar masa lidhur me garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, në kundërshtim me pikën 1/c të këtij neni;
- Nuk janë parashikuar masa lidhur me përhapjen e të dhënave personale të kreditorëve, në kundërshtim me pikën 1/a të këtij neni;
- Nuk është parashikuar ç'farë do të ndodhi me të dhënat personale pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, në kundërshtim me pikën 1/ç të këtij neni;
- Nuk janë parashikuar masa lidhur me vendosjen në dispozicion të kontrolluesit të të gjithë informacionit të nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas kësaj dispozite, në kundërshtim me pikën 1/d të këtij neni.

Zyra e Komisionerit vlerëson se garantimi i të drejtave të subjekteve garanton përpunimin e ligjshëm, të saktë dhe të drejtë të të dhënave personale. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e përpunuesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit parashtruan se ishte ankuesi

i cili u kishte vendosur në dispozicion adresat e prindërve me qëllim kontaktimin e tij si dhe njoftimet janë komunikuar sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Civile.

Lidhur me pretendimet e paraqitura me shkrim nga kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Në këtë rast, ekzistenca e pëlqimit është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale të ankuesit si dhe të subjekteve të cilëve u janë përpunuar të dhënat. Elite Consulting Shpk nuk është në gjendje që të provojë marrjen e pëlqimit për përpunimin/përhapjen e të dhënave drejt subjekteve të tjera të të dhënave, sipas parashikimit në nenin 3 pika 24 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Për sa kohë nuk është parashikuar në marrëveshjen e kredisë të nënshkruar nga ankuesi me shoqërinë IuteCredit Albania Sh.a kontaktimi i subjekteve të të dhënave (prindërit e ankuesit) përpunimi/përhapja e të dhënave është e paligjshme duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në nenin 5/1/a të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky lloj përpunimi nuk garanton zbatimin e nenit 6/1/a të Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Të dhënat personale përpunohen vetëm: *a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;...*

Sa i përket pretendimeve të tjera të paraqitura nga kontrolluesi lidhur me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile mbi njoftimet, Zyra e Komisionerit vlerëson se ato nuk kanë të bëjnë me këtë procedurë specifike të lajmërimit të debitorit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 20, 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi Elite Consulting Sh.p.k, në zbatim të neneve 5/1/a dhe 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme të të dhënave personale, duke siguruar dhe provuar pëlqimin paraprak për të gjithë subjektet e të dhënave, të dhënat e të cilëve përpunohen dhe administrohen me qëllim kontaktimin e debitorëve.
2. Elite Consulting Sh.p.k, në cilësinë e përpunuesit të të dhënave, të përfshijë në marrëveshjen me IuteCredit Albania Sh.a detyrimet sipas parashikimit në nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe në Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes

kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar.

3. Elite Consulting Sh.p.k, në cilësinë e kontrolluesit ose përpunuesit, të ketë në vëmendje për raste të tjera të ngjashme, përfshirjen në marrëveshjet me kontrolluesit detyrimet sipas parashikimit të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimit të parashikuar në pikën 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 06/12 /2018

**KOMISIONERI**  
**Besnik Deryishi**

